



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr.1412 Prot.

Lezhë, me 03.02.2023

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL
NË KATEGORINË E MESME DREJTUESE**

**LLOJI I DIPLOMËS SHKENCA SHOQËRORE,
NIVELI MINIMAL I DIPLOMËS MASTER SHKENCOR**

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, ”, Urdhërit nr.633 datë 30.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës, organikës , emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë , të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2023”, Planit të Pranimeve në Shërbimin Civil të vitit 2023, miratuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.02, datë 06.01.2023, Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr.30 datë 27.01.2023 “Për miratimin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të cilat do të jenë të hapura për konkurim nga jashtë shërbimit civil”, Bashkia Lezhë shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

1. Drejtor në Drejtorinë e Turizmit dhe Kulturës, në Bashkinë Lezhë- Kategoria II-b.

Plotësimi i pozicionit më sipër bëhet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Për këtë procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të nenit 26/4).

Për të tre procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë, pranim nga jashtë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE	13.02.2023
Afati për dorëzimin e dokumentave për: NGRITJE NË DETYRË	13.02.2023
Afati për dorëzimin e dokumentave për: PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL	17.02.2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Organizon, koordinon dhe drejton punën brenda drejtorisë duke bërë ndarjen e detyrave për punonjësit e drejtorisë si dhe duke mbikëqyrur dhe siguruar kryerjen në kohë dhe me cilësi të detyrave nga ana e këtyre punonjësve;
- Mundëson kushtet normale për funksionimin efektiv të drejtorisë. Realizon ndarjen e punës, jep instruksione dhe ndihmën e domosdoshme për vartësit direkt për përmbushjen e detyrave;
- Siguron marrëdhënie të rregullta komunikimi me punonjësit e drejtorisë duke garantuar vazhdimësinë e operacioneve të punës nëpërmjet transparencës në transmetimin e urdhrave. Siguron zbatimin e programit të detyrave për drejtorinë duke klasifikuar përparësitë;
- Kontrollon, rishikon dhe nënshkruan të gjitha materialet dhe korrespondencat e hartuara nga punonjësit e drejtorisë, para paraqitjes për miratim dhe nënshkrim tek Kryetari i Bashkisë. Kontrollon, analizon, vlerëson dhe informon drejtpërdrejt kryetarin mbi rezultatet e punës të punonjësve të drejtorisë dhe propozon për shpërblimin dhe kualifikimin mëtejshëm të tyre.
- Analizon mbarëvajtjen e përmbushjes së detyrave nga ana e drejtorisë, informon drejtpërdrejt kryetarin mbi punën kryer si dhe paraqet opinione në lidhje me këtë çështje;
- Përcakton procedurat dhe mënyrat e punës si dhe jep instruksionet dhe ndihmën e domosdoshme për punonjësit e drejtorisë me qëllim përmbushjen e detyrave nga ana e tyre.
- Koordinon veprimtarinë e specialistëve të drejtorisë në funksion të zgjidhjes së problemeve të ndryshme. Këshillon dhe orienton specialistet e drejtorisë që drejton me qëllim realizimin e suksesshëm të detyrave.
- Zbaton detyrat e ngarkuara sipas rregulloreve në fuqi si dhe planeve të punës të miratuara nga Kryetari i Bashkisë. Kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga kryetari në përputhje me misionin dhe objektivat e Drejtorisë.
- Organizon punën dhe merr masa konkrete për zbatimin në kohë të detyrave të caktuara nga kryetari për sektoret në varësi;
- Planifikon objektiva për drejtorisë dhe kujdesët që ato të arrihen në afatet e caktuar dhe me cilësi. Përpunon dhe analizon të dhëna statistikore mbi sektoret e turizmit dhe kultures si dhe kryen kërkime dhe bën analiza për forma të reja në këtë fushë;
- Menaxhon punën e stafit në varësi, ndan detyra, vlerëson punën e tyre dhe kujdesët që kur është nevoja ata të marrin trajnimet e duhura për punën e tyre. Menaxhon politikat zhvillimore në funksion të turizmit dhe kultures.
- Drejton hartimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin e turizmit dhe kultures në bashki, në përputhje me strategjitë kombëtare dhe strategjinë e përgjithshme të zhvillimit të bashkisë.
- Promovon në panairë si dhe në çdo mënyrë tjetër turizmin dhe kulturen si dhe të bashkpunojë me institucione të tjera, organizata për të siguruar aktivitete të turizmit, kulturës, panairë etj.
- Bashkëpunon me Institucionet e tjera, drejtorite e bashkise dhe sektorë të tjerë për përmirësimin e shërbimeve, mirëmbajtjen dhe pasurimin e infrastrukturës së nevojshme.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria II-b);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë në Shkenca Shoqërore, Niveli minimal i Diplomës “Master Shkencor”, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite në administratën shtetërore ose vendore.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar.
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, te Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese, brenda datës 13.02.2023.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **15.02.2023** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku

ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij,
- b. Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”,
- c. Njohuritë mbi Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- d. Njohuritë mbi Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,
- e. Njohuritë mbi ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar,
- f. Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- g. Njohuritë mbi ligjin nr. Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për levizjen paralele, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

*Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Lezhë duke filluar nga data **15.02.2023**.*

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë,

Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lire (në zbatim të vendimit të titullarit por që nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në cdo vit kalendarik, neni 26/4).

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë e ulët drejtuese.
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli minimal i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë në Shkenca Shoqërore, Niveli minimal i Diplomës “Master Shkencor”, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite në administratën shtetërore ose vendore.
- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTECIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, te Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Sherbimeve Mbeshtetese brenda datës 17.02.2023, në Bashkinë Lezhë.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 27.02.2023, Drejtoria e Burimeve Njerezore e Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe faqen zyrtare të bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- h. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij,
- i. Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”,
- j. Njohuritë mbi Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- k. Njohuritë mbi Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,
- l. Njohuritë mbi ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar,
- m. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- n. Njohuritë mbi ligjin nr. Nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndrysh

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për ngritje në detyrë, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,

- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Lezhë duke filluar nga data **27.02.2023**.

3 PRANIM NGA JASHTË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë.

3.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NGA JASHTË DHE KRITERET E VEÇANTA

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati jashtë shërbimit civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- d) Të zotërojnë diplomë në Shkenca Shoqërore, Niveli minimal i Diplomës “Master Shkencor”, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- e) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- f) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 2 vite në administratën shtetërore ose vendore.

3.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- j- Jetëshkrim i plotësuar
- k- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- l- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- m- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- n- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- o- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- p- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- q- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- r- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, te Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Sherbimeve Mbeshtetese brenda datës 17.02.2023 në Bashkinë Lezhë.

3.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 27.02.2023 Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Lezhë do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

3.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- o. Njohuritë mbi Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij,
- p. Njohuritë mbi Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”,
- q. Njohuritë mbi Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995, Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- r. Njohuritë mbi Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar,
- s. Njohuritë mbi ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar,
- t. Njohuritë mbi Ligjin Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,
- u. Njohuritë mbi ligjin nr. Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- d- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- e- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- f- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

3.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

3.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Bashkisë Lezhë do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Bashkia Lezhë do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të bashkisë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimin nga jashtë, do të marrin informacion në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,

- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Lezhë duke filluar nga data **27.02.2023**.

KRYETARI
Pjerin Ndreu